

## MONEDHA EURO ËSHTË TEK PRAGU

Selami Xhepa\*

Fjalë kyçe

- Euro - Monedhë ligjore - Banka Qendrore Evropiane - Bashkimi Monetar Evropian - Zona e Euros -

Boks. 1 Monedhat që dalin nga qarkullimi:

Marka gjermane
Franga franceze
Lireta italiane
Gulden holandez
Franga belge
Franga luksemburg
Paund irlandez
Eskudo portugeze
Peseta spanjolle
Shilinga austriake
Marka finlandeze
Dhrahmia greke

### HYRJE

Siç është bërë e ditur që nga 1 janari 1999, Sistemi Monetar Evropian hyri në fazën përfundimtare të tij: u krijua një monedhë unike (EURO) dhe një bankë qendrore e përbashkët (Banka Qendrore Evropiane). Plani i kalimit drejt kësaj faze parashikonte një periudhë tranzitore trevjeçare gjatë së cilës, jo vetëm do të

thellohej më tej konvergjenca ekonomike dhe monetare brenda vendeve anëtare, por dhe do të bëheshin përgatitjet teknike për zëvendësimin fizik të monedhave të vendeve anëtare me monedhën e re.

Tashmë, nuk ka mbetur më shumë se gjysmë viti kur bota do të shohë këtë monedhë të re të qarkullojë në treg si monedhën e vetme ligjore. Nga 1 janari 2002 në të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, do të qarkullojë fizikisht monedha e re. Për të bërë zëvendësimin fizik të të gjitha monedhave të vendeve anëtare që janë në qarkullim, autoritetet vendimmarrëse kishin parashikuar një kohë tranzitore prej gjashtë muajsh (nga 1 janari – 30 qershor 2002).

Më vonë kjo periudhë u shkurtua në dy muaj. Kjo do të thotë se, nga 1 mars 2002, prerjet e monedhave aktuale të vendeve anëtare të kësaj zone, pushojnë së vepruari si monedha ligjore. Ky shkrim ka për qëllim të shikojë në disa probleme specifike dhe praktike për zëvendësimin fizik të këtyre monedhave që qarkullojnë në vendin tonë.

1. Si dhe kur do të kryhet zëvendësimi fizik i monedhave?
2. Ku mund të kryhet zëvendësimi?
3. A do t'i kushtojë kjo konsumatorëve dhe kush do t'i përballojë këto kosto?
4. Çfarë vendimesh duhet të merren nga autoritetet e vendit (Banka e Shqipërisë dhe bankat tregtare)?

## 1. SI DHE KUR DO TË KRYHET ZËVENDËSIMI FIZIK I MONEDHAVE?

Zëvendësimi në çdo vend anëtar të Zonës së Euros, nuk do të kryhet sipas të njëjtit kalendar. Çdo vend ka përshtatur një kalendar kohor të vetin. Sidoqoftë, koha kur do të nisë ky proces zëvendësimi është data 1 janar 2002. Autoritetet evropiane

kanë vendosur që ky operacion të kryhet deri në datën 28 shkurt (megjithëse vëmendja e tyre është që zëvendësimi të kryhet brenda dy javësh).


Pra, nga data 1 mars 2002, lira, marka, drahmia etj., do të mbeten thjesht si relike historike. Meqenëse bëhet fjalë për transportimin e një sasive tepër të madhe (dhe që konsiderohet si një nga sfidat më të mëdha logjistike), shpërndarja e euros në banka do të fillojë që në muajin shtator 2001. Gjatë periudhës shtator-dhjetor 2001, bankat nga ana e tyre, do të shpërndajnë euro në dyqanet e shitjes me pakicë. Megjithatë, Banka Qendrore Evropiane ka kundërshtuar që euro t'u shpërndahet klientëve para datës 1 janar 2002. Përmasat tepër të mëdha të këtij operacioni kanë krijuar një lloj frike, lidhur me problemet e sigurisë së transportit të kësaj sasive tepër të madhe parash (660 miliardë euro), për rrjedhojë, autoritetet monetare kanë kërkuar edhe ndërhyrjen e ushtrisë (përveç forcave të sigurimit dhe të policisë). Me përjashtim të Gjermanisë, në të gjitha vendet e tjera, klientët mund të këmbëjnë paratë e vjetra me të reja në çdo degë banke. Në Gjermani, bankat do të bëjnë këmbimin vetëm për klientët e tyre. Pra, secili duhet të hapë një numër llogarie gjatë kësaj periudhe. Kjo masë është marrë për të penguar pastrimin e parave që shumë analistë mendojnë se mund të hyjnë nga vendet e Evropës Lindore.

Konsumatorët shqiptarë, biznesmenët, kambistët dhe agjentët e tjerë ekonomikë, kanë në përdorim dhe qarkullojnë monedha të vendeve të ndryshme. Një pjesë e madhe monedhash në qarkullim, i përkasin vendeve anëtare të Bashkimit Monetar Evropian, të cilat do t'i heqin ato nga qarkullimi duke i zëvendësuar me monedhën e re. Kjo do të thotë se, çdo mbajtës i një monedhe të tillë (shih boks. 1 për monedhat që dalin nga qarkullimi) duke filluar nga data 1 janar 2002, mund të fillojë të kryejë zëvendësimin fizik të tyre. A ka rëndësi që zëvendësimi i monedhave në euro të bëhet sipas afateve që do të bëhen dhe në vendet anëtare? Jo, nuk është e rëndësishme, përderisa monedhat përbërëse të euros nuk janë monedha që përdoren si mjet pagese në vendin tonë (kryesisht ato luajnë funksionin si mjet i rezervës – pra për kursime). Për rrjedhojë, megjithëse

zëvendësimi mund të fillojë dhe në vendin tonë, nga muaji janar 2002, periudha për t'i zëvendësuar ato pritet të shkojë deri në 10 vjet. (Kjo periudhë është përcaktuar që është e vlefshme në vendet anëtare të Zonës së Euros.) Por, monedhat e vjetra nuk mund të përdoren në asnjë transaksion tregtar.

Kushdo që do të udhëtojë në një nga këto shtete, duke filluar nga data 1 mars nuk mund të bëjë asnjë lloj pagese në monedha të vjetra, përveçse në euro.

Më e rëndësishme kjo periudhë është për biznesmenët shqiptarë, që kryejnë transaksione tregtare me një nga këto vende. Duke filluar që nga 1 janari, faturimet (pagesat) e mallrave të importuar nga këto vende, do të kryhen vetëm në euro. Për rrjedhojë, biznesmenët duhet të kontaktojnë me bankat në të cilat mbajnë gjendjen e tyre të llogarive, për të marrë informacionet e nevojshme.



Si do të bëhet zëvendësimi? Siç dihet, monedhat pjesëmarrëse në Bashkimin Monetar Evropian, kanë një kurs këmbimi të fiksuar kundrejt euros. Pra, lira, marka dhe monedhat e tjera që qarkullojnë, kanë një kurs këmbimi të fiksuar kundrejt euros.

Tabelë 1. Kurset dypalëshe të këmbimit.

Vendet	Kursi
Gjermani (DEM)	1.95583
Francë (FRF)	6.55957
Itali (ITL)	1936.27
Holandë (NLG)	2.20371
Belgjikë (BEF)	40.3399
Luksemburg (LUF)	40.3399
Irlandë (IEP)	0.787564
Portugali (ESP)	166.386
Spanjë (PTE)	200.482
Austri (ATS)	13.7603
Finlandë (FIM)	5.94573
Greqi (GRD)	340.75

Duke lexuar tabelën e mësipërme, do të thotë se: për të blerë 1 euro duhet të jepni 1.95583 marka gjermane ose 1936.27 lira italiane etj.. Ose nëse ju keni 1000 marka gjermane, kur t'i dorëzoni në bankë për të bërë zëvendësimin e tyre në euro, ju do të merrni:  $1000 \text{ marka} / 1.95583 = 511.3 \text{ euro}$ .

Ky është kursi i këmbimit i fiksuar në Zonën e Euros. Banka e Shqipërisë duhet të nxjerrë një vendim që të detyrojë të gjitha bankat, të cilat do të kryejnë zëvendësimin e monedhave, që të respektojnë këtë nivel të kursit të këmbimit. Por, nëse dikush vendos të këmbëjë në dollarë, kursi i këmbimit të euros (pra, dhe monedhave përbërëse) është i luhatshëm. Pra, në këtë rast klientët duhet të ndjekin ecurinë e kursit të këmbimit në treg.

## 2. KU MUND TË KRYHET ZËVENDËSIMI FIZIK I MONEDHAVE?

Në vendet anëtare të Zonës së Euros, zëvendësimi fizik i monedhave do të kryhet qoftë në banka, në institucione financiare, në ATM-të, në zyrat e postave dhe në dyqane. Llogaritë bankare zëvendësohen automatikisht me monedhë të

re (këto në fakt janë zëvendësuar) titujt e letrave me vlerë të pronësisë apo të borxhit, gjithashtu, do të shprehen në euro.

Po qytetarët shqiptarë, që mbajnë monedha të këtyre vendeve, jashtë sistemit bankar apo dhe nëpër banka?

Nëse monedhat e këtyre vendeve janë të vendosura në banka, secili do të jetë në gjendje të tërheqë monedhën e re euro pasi bankat do të përgatiten t'i zëvendësojnë fizikisht ato. Nëse dikush mban monedha të këtyre vendeve si kursime në shtëpi, pra jo në banka, përsëri është e mundur që të bëhet zëvendësimi fizik i monedhave duke u paraqitur në sportelet e bankave.

Megjithatë, Banka e Shqipërisë duhet të përcaktojë zyrtarisht emrat e bankave (apo edhe të zyrave të këmbimeve valutore) dhe të bëjë njoftime publike për këtë qëllim. Kjo do të shmangte mundësitë e spekulimeve në dëm të konsumatorëve të pambrojtur.

### 3. KUSH DO TË PAGUAJË KOSTON E KËTIJ ZËVENDËSIMI?

Emetimi i monedhave të reja ka një kosto të caktuar, që lidhet me printimin, me letrën etj.. Sipas udhëzimeve të Bankës Qendrore Evropiane, zëvendësimi fizik i monedhës nuk do të shoqërohet me kosto për konsumatorët. Shpenzimet që lidhen me këtë proces normalisht do të përballohen nga bankat qendrore të vendeve anëtare, të cilat janë njëkohësisht përgjegjëse për emetimin dhe shpërndarjen e monedhave në qarkullim.

Zëvendësimi fizik, në rastin e vendeve jashtë Zonës së Euros, duhet të bëhet me marrëveshje formale mes bankave qendrore. Kjo do të thotë, se Banka e Shqipërisë duhet të fillojë të kontaktojë me bankat qendrore të vendeve të Zonës së Euros dhe të lidhë marrëveshje dypalëshe për zëvendësimin e monedhave. Duhet të jetë përgjegjësi e Bankës së Shqipërisë që të përcaktojë termat

kontraktuale për dorëzimin e monedhave ekzistuese, për marrjen e monedhave të reja, për shpërndarjen etj.. Banka e Shqipërisë duhet të marrë vendimet përkatëse edhe lidhur me përballimin e kostove që do të shoqërojnë këtë proces. Në parim, këto kosto duhet të përballohen ose nga Banka e Shqipërisë ose të ndahen me bankat tregtare. Nuk do të ishte e arsyeshme që konsumatorët të përballojnë kostot e këtij procesi.

#### 4. ÇFARË VENDIMESH DUHET TË MARRIN AUTORITETET MONETARE TË VENDIT?

Sipas një vendimi të Bankës Qendrore Evropiane, bankat dhe institucionet financiare dhe të kreditit do të kenë të drejtën që të furnizojnë me monedhën e re, filialet, degët apo institucionet e tyre në vendet jashtë Zonës së Euros. Kjo do të thotë, se bankat e huaja që punojnë në vendin tonë, do të kenë të drejtën të furnizohen nga bankat e tyre mëmë në vendet përkatëse. Banka e Shqipërisë duhet të hyjë në kontakte me këto institucione që të koordinojë këtë proces nëpërmjet marrëveshjeve formale për të siguruar një tranzicion normal dhe të mbyllë mundësitë spekulative që mund të krijohen.

Banka e Shqipërisë duhet që të drejtojë operacionin e zëvendësimit monetar, duke caktuar zyrtarisht bankat si operatore të zëvendësimit dhe vetë Banka e Shqipërisë të sigurojë furnizimin me monedhën e re në sasi të nevojshme. Kjo kërkon që vetë ajo të nënshkruajë marrëveshje kontraktuale me bankat qendrore të vendeve të Zonës së Euros, për të specifikuar detajet e këtij procesi, si dhe me bankat tregtare që veprojnë në Shqipëri.

Veç aspekteve të tilla teknike, Banka e Shqipërisë duhet të kujdeset që ky proces të kalojë pa shqetësime. Kjo kërkon edhe një fushatë intensive të ndërgjegjësimit të publikut të vendit, informimin e tij për detajet e këtij procesi etj..

## 5. A MBART RREZIQE KY PROCES?

Banka Qendrore Evropiane dhe autoritetet e vendeve të Zonës së Euros, kanë lëshuar instruksione të detajuara për problemet e sigurisë që do të shoqërojnë këtë fazë tranzitore. Nuk mendohet se do të ketë probleme shqetësuese, edhe pse prerjet e monedhës së re shkojnë dhe në denominimin prej 500 euro.

Nuk ka arsye për të besuar se ky proces mund të mbartë rreziqe për konsumatorët kursimtarë apo për agjentët e tjerë ekonomikë të vendit tonë. Edhe vetë afati i zëvendësimit nuk përfundon brenda një periudhe kohe të dhënë. Bankat qendrore të vendeve të Zonës së Euros, do të kenë të drejtën të kryejnë zëvendësimin fizik të monedhave edhe për afate kohe më të gjata (deri në 10 vjet), edhe pse monedhat aktuale të tyre nuk mund të përdoren. Kjo do të thotë se, Banka e Shqipërisë në marrëveshjet që duhet të nënshkruajë me bankat qendrore të këtyre vendeve, duhet të parashikojë mundësitë e zëvendësimit fizik edhe për afate kohore më të gjata. Në thelb, ky proces do të jetë i ngjashëm me çdo zëvendësim të monedhave që ka ndodhur dhe më parë në vendin tonë (dalja nga qarkullimi i monedhave me prerje të vjetra).

Por, ky proces i zëvendësimit fizik të monedhave, mund të jetë një rast për pastrimin e parave nëpërmjet bankave. Ky është në fakt dhe shqetësimi më i madh për sistemin bankar evropian. Mundet që monedha të falsifikuara, që janë aktualisht në qarkullim, të zëvendësohen me euro në banka. Kjo për shkak të rradhëve të gjata, që mendohet se do të krijohen në sportelet e bankave dhe pamundësisë së zyrtarëve të bankave për të kontrolluar çdo njësi të monedhave që do të kërkohet të zëvendësohen.

Megjithëse një gjë e tillë nuk është shumë e mundur të ndodhë në vendin tonë, Banka e Shqipërisë duhet të nxjerrë udhëzime të detajuara për t'u zbatuar nga sistemi bankar i vendit dhe të shoqërojë me një mbikëqyrje të kujdesshme këtë proces.



Vetë euro është një monedhë e re dhe e pafalsifikuar, por mund të zëvendësohen prerje të falsifikuara markash, lirash etj., të cilat mund të jenë në qarkullim qoftë në vendin tonë, ose të vijin nga vende të tjera të rajonit ku qarkullojnë sasi të mëdha, kryesisht të markave.

Një tjetër shqetësim, që mund të krijohet, lidhet me kursin e këmbimit. Nëse klientët nuk do të dëshirojnë të këmbëjnë kursimet e tyre valutore në lira, marka, drahmi etj. në euro, por të zgjedhin dollarin si monedhë të tyre të preferuar, në tregun e brendshëm kjo mund të vendosë euron nën presione zhvlerësuese artificiale ose spekulative. Banka e Shqipërisë duhet të luajë një rol frenues në këtë drejtim, duke ndjekur situatën e tregut valutor në mënyrë të kujdesshme dhe të bëjë ndërhyrjet e nevojshme për të mos lejuar spekulimet që mund të rezultojnë. Veçanërisht mundësi spekulimesh mund të krijohen në tregun joformal të këmbimit. Banka e Shqipërisë duhet të lëshojë mesazhe të vazhdueshme tek publiku gjatë gjithë kësaj periudhe.

Duke përfunduar:

Nuk besojmë se ka ndonjë arsye për të krijuar shqetësime për këtë proces të zëvendësimit fizik të kursimeve valutore jo në dollarë, që njerëzit mbajnë qoftë në shtëpi apo nëpër banka. Ky proces do të ketë një shtrirje kohore të mjaftueshme. Banka e Shqipërisë duhet të marrë masat e nevojshme për t'i paraprirë këtij procesi dhe për një mbikëqyrje të kujdesshme.

Banka e Shqipërisë duhet të fillojë të bëjë përgatitjet e nevojshme teknike për këtë proces, të nxjerrë udhëzime të nevojshme për bankat dhe për zyrat e këmbimeve valutore, të familjarizojë publikun me monedhën e re etj.. Edhe vetë departamentet e Bankës së Shqipërisë duhet të evidentojnë çështjet e tyre specifike që lidhen me këtë proces dhe të jenë të përgatitura në kohë.

---

\* Selami Xhepa, specialist, Departamenti i Kërkimeve.

